



Kriteret e Këshillit Global për Turizëm të Qëndrueshëm

VERSIONI 1, 1 NËNTOR 2013

DHE

Indikatorët e sugjeruar të performancës

VERSIONI 1, 10 DHJETOR 2013

PËR

DESTINACIONET

Hyrje

Turizmi i qëndrueshëm është në rritje: kërkesa e konsumatorëve është duke u rritur, furnizuesit e industrisë së turizmit zhvillojnë programe të reja të gjelbër, dhe qeveritë si dhe agjencitë ndërkombëtare krijojnë politika të reja që të inkurajojnë praktikën e qëndrueshme në turizëm. Por çfarë domethënë "turizmi i qëndrueshëm" në të vërtetë? Si mund të matet dhe të prezantohet në mënyrë të besueshme me qëllim që të ndërtohet besim tek konsumatorët, të promovohet përparimi i biznesit, sigurohet dobi për bashkësinë dhe të luftohet kundër kërkesave false?

Kriteret e Këshillit Global për Turizëm të Qëndrueshëm (KGTQ) janë krijuar për të siguruar një kuptim të përbashkët mbi "turizmin e qëndrueshëm". KGTQ paraqesin nivelin minimal që secili biznes i turizmit duhet të synojë të arrijë duke pasur qëndrueshmërinë në praktikën e tyre. Për të plotësuar definicionin e turizmit të qëndrueshëm, destinacionet duhet të kenë një qasje ndërdisiplinore, gjithëpërfshirëse dhe integruese, e cila përfshin katër objektiva: (i) të tregojnë menaxhim të qëndrueshëm të vendit, (ii) të maksimizojë përfitimet sociale dhe ekonomike për komunitetin vendas dhe të minimizojë ndikimet negative; (iii) të maksimizojë përfitimet për komunitetet, vizitorët dhe trashëgiminë kulturore dhe të minimizojë ndikimet, dhe (iv) të maksimizojë përfitimet për mjedisin dhe të minimizojë ndikimet negative. Kriteret e KGTQ janë dizajnuar që të përdoren nga të gjitha llojet dhe shkallët e destinacioneve.

KGTQ kriteret u krijuan nga komuniteti i turizmit pjesërisht si përgjigje ndaj sfidave globale të Objektiveve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara. Zbutja e varfërisë, barazia gjinore dhe qëndrueshmëria mjedisore (duke

përfshirë ndryshimet klimatike) janë çështjet kryesore ndërsektoriale që trajtohen në kriteret e KGTQ. Kriteret dhe treguesit e KGTQ u zhvilluan në bazë të kritereve dhe qasjeve tashmë të pranuar, përfshirë: indikatorët e nivelit të destinacionit UNWTO, Kriteret e KGTQ për hotelierët dhe operatorët turistikë, parimet dhe udhëzimet gjerësisht të pranuar, kriteret dhe treguesit e certifikimit. Ato pasqyrojnë standartet e qëndrueshme të certifikimit të turizmit, treguesit, kriteret dhe praktikën më të mira nga kontekste të ndryshme kulturore dhe gjeopolitike botërore. Treguesit e mundshëm u shqyrtuan për rëndësinë dhe praktikitetin, si dhe zbatueshmërinë e tyre në një gamë të gjerë të llojeve të destinacioneve.

Kriteret e KGTQ administrohen nga Këshilli i Turizmit të Qëndrueshëm Global. Disa nga përdorimet e përitura të kritereve nga organizatat e menaxhimit të turizmit përfshijnë:

Të shërbejë si udhëzues bazë për destinacionet që dëshirojnë të bëhen më të qëndrueshme

Të ndihmojë konsumatorët të identifikojnë destinacione të qëndrueshme turistike

Të shërbejë si një emërues i përbashkët për mediat që të njohin vëllime dhe të informojnë publikun për përpjekjet personale të qëndrueshmërisë

Ndihmë për certifikim dhe programe tjera vullnetar të nivelit të destinacionit të cilat sigurojnë që standartet e tyre të përmbushin një bazë të pranuar gjerësisht

Ofrimi i programeve për organizatat qeveritare, joqeveritare dhe sektorin privat si pikënisje për zhvillimin e kërkesave të turizmit të qëndrueshëm

Të shërbejë si udhëzues bazë për organet e arsimit dhe trajnimit, siç janë shkollat e hotelierëve dhe universitetet

Kriteret përcaktojnë se çfarë duhet të bëhet, jo në çfarë mënyre ose nëse qëllimi është arritur. Ky rol plotësohet nga indikatorët e performancës, materialet përkatëse arsimore dhe qasje në mjetet për zbatim nga ofruesit e shërbimeve të sektorit publik, OJQ dhe privat, të gjitha që janë një plotësim i domosdoshëm i KGTQ Kriterëve. KGTQ Kriteret për Vende janë paraparë si nismë e procesit për të bërë qëndrueshmërinë praktikë standarde në të gjitha format e turizmit.

Përdorimi i kritereve

Rekomandohet që gjithë kriteret të përdoren në nivelin më të lartë praktik, përveç në disa raste specifike në të cilat kriteri nuk mund të zbatohet dhe ka arsytim të fuqishëm për atë. Mund të paraqiten situata ku kriteri nuk mund të zbatohet për ndonjë destinacion të caktuar turistik ose organizatë për menaxhim të ndonjë destinacioni. Kjo mund të jetë për shkak të kushteve lokale të rregullimit, mjedisit, kushteve sociale, ekonomike ose kulturore. Në rast të bizneseve të vogla dhe komuniteteve të vogla, kuptohet që resurset e kufizuara mund të shkaktojnë që mos të mund të zbatohen gjitha kriteret.

Për shkak se destinacionet përbëhen nga shumë ndërmarrje, organizata dhe individë të ndryshëm, zbatimi i këtyre kritereve duhet të përfshijë shqyrtimin e plotë të efekteve kumulative të aktiviteteve. Matja në shkallën e destinacionit zakonisht do të kapë rezultatin neto të efekteve kumulative në shkallë individuale. Megjithatë, monitorimi i ndikimeve nuk është një qëllim në vetvete, ai duhet të shihet si një mjet për të përmirësuar qëndrueshmërinë e destinacionit. Udhëzime të mëtejshme mbi këto kritere mund të gjenden nga treguesit mbështetës dhe fjalorthi, i cili do të publikohet nga Këshilli i Turizmit të Qëndrueshëm Global.

Indikatorët e performancës

Indikatorët e performancës të prezantuar në këtë dokument janë dizenuar për të siguruar udhëzime për matjen e përputhjes me Kriteret e KGTOQ-së për destinacionet. Ato nuk synojnë të jenë përcaktimi përfundimtar ose gjithëpërfshirës, por të sigurojnë një grup të caktuar të mostrës për përdoruesit e KGTOQ-së për destinacionet në zhvillimin e grupeve të tyre të treguesve.

Kjo listë e indikatorëve do të përditësohet në baza periodike, me zhvillimin e informacioneve të reja. Nëse dëshironi të propozoni indikatorë të rinj ose të sugjeroni përmirësim, ju lutemi që të dërgoni në: destinations@gstccouncil.org.

Indikatorë dhe kritere të kombinuara

Ky dokument përmban kriteret dhe indikatorët e performancës, për tekstin zyrtar vizitoni www.gstccouncil.org

KRITERE	INDIKATORËT
SEKSIONI A: Demonstron menaxhim të qëndrueshëm efektiv	
A1 Strategjia e qëndrueshme e destinacionit Destinacioni ka krijuar dhe zbaton strategji shumëvjeçare që është në dispozicion të publikut, është e përshtatshme për shkallën e tij; i konsideron çështjet e mjedisit jetësor, ato ekonomike, sociale, kulturore, cilësore, shëndetësore dhe të sigurisë, si dhe çështje estetike; dhe është zhvilluar me pjesëmarrjen e publikut.	IN-A1.a. Strategji shumëvjeçare e destinacionit që përfshin fokus në qëndrueshmërinë dhe turizmin e qëndrueshëm dhe përfshin çështjet e mjedisit jetësor, ato ekonomike, sociale, kulturore, cilësore, shëndetësore dhe të sigurisë IN-A1.b. Plan ose strategji shumëvjeçare e destinacionit që është e përditësuar dhe në dispozicion për publikun IN-A1.c. Plan ose strategji shumëvjeçare e destinacionit që është zhvilluar me pjesëmarrjen e publikut IN-A1.d. Angazhimi politik për të zbatuar planin shumëvjeçar të destinacionit dhe dëshmi të zbatimit
A2 Organizata e menaxhimit të destinacionit Destinacioni ka organizatë, departament, grup ose komision efektiv përgjegjës për një qasje të koordinuar për turizmin e qëndrueshëm, me përfshirjen e sektorit privat dhe të sektorit publik. Ky grup është i përshtatshëm për madhësinë dhe shkallën e destinacionit dhe ka të përcaktuar përgjegjësitë, mbikëqyrjen dhe aftësitë e zbatimit për menaxhimin e çështjeve të mjedisit jetësor, ato ekonomike, sociale dhe kulturore. Aktivitetet e këtij grupi financohen në mënyrë të përshtatshme.	IN-A2.a. Një organizatë ka përgjegjësi për një qasje të koordinuar për menaxhimin e turizmit të qëndrueshëm IN-A2.b. Sektori privat dhe sektori publik janë të përfshirë në organizimin dhe koordinimin e turizmit IN-A2.c. Organizata turistike është e përshtatshme për madhësinë dhe shkallën e destinacionit IN-A2.d. Individët brenda organizatës së turizmit kanë përgjegjësi të caktuara për turizmin e qëndrueshëm IN-A2.e. Organizata e turizmit financohet në mënyrë të duhur

<p>A3 Monitorimi</p> <p>Destinacioni ka sistem për të monitoruar, raportuar publikisht dhe për t'iu përgjigjur çështjeve të mjedisit jetësor, ato ekonomike, sociale, kulturore, turizmit dhe të drejtave të njeriut. Sistemi i monitorimit rishikohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike.</p>	<p>IN-A3.a. Monitorimi aktiv dhe raportimi publik i çështjeve të mjedisit jetësor, ato ekonomike, sociale, kulturore, të turizmit dhe të të drejtave të njeriut</p> <p>IN-A3.b. Sistemi i monitorimit rishikohet dhe vlerësohet në mënyrë periodike</p> <p>IN-A3.c. Procedurat e zbutjes së ndikimit të turizmit të financuara dhe aktive.</p>
<p>A4 Menaxhimi i sezonalitetit të turizmit</p> <p>Destinacioni dedikon burime për të zbutur ndryshueshmërinë sezonale të turizmit aty ku është e përshtatshme, duke punuar për të balancuar nevojat e ekonomisë lokale, komunitetit, kulturave dhe mjedisit jetësor, për të identifikuar mundësitë e turizmit gjatë gjithë vitit.</p>	<p>IN-A4.a. Strategji specifike për marketingun e ngjarjeve jashtë sezonit dhe tërheqjen e vizitorëve gjatë gjithë vitit</p>
<p>A5 Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike</p> <p>Destinacioni ka një sistem për të identifikuar rreziqet dhe mundësitë që lidhen me ndryshimet klimatike. Ky sistem inkurajon strategjitë e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike për zhvillimin, vendndodhjen, dizajmin dhe menaxhimin e objekteve. Sistemi kontribuon në qëndrueshmërinë dhe durueshmërinë e destinacionit dhe në edukimin publik për klimën për banorët dhe turistët.</p>	<p>IN-A5.a. Sistemi aktual për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe vlerësimin e rrezikut</p> <p>IN-A5.b. Ligje ose politika për të zbutur ndryshimet klimatike dhe për të inkurajuar teknologjitë për të zbutur ndryshimet klimatike</p> <p>IN-A5.c. Program për edukimin dhe ngritjen e vetëdijes së publikut, ndërmarrjeve turistike dhe vizitorëve rreth ndryshimeve klimatike</p>
<p>A6 Inventarizimi i pasurive dhe atraksioneve turistike</p> <p>Destinacioni ka inventar të përditësuar dhe në dispozicion publik dhe vlerësim të pasurive dhe atraksioneve turistike, duke përfshirë vendet natyrore dhe kulturore.</p>	<p>IN-A6.a. Inventarizimi aktual dhe klasifikimi i aktiveve turistike dhe atraksioneve duke përfshirë destinacionet natyrore dhe kulturore</p>
<p>A7 Rregulloret e Planifikimit</p> <p>Destinacioni ka udhëzime, rregullore dhe/ose politika të planifikimit që kërkojnë vlerësim të ndikimit mjedisor, ekonomik dhe social dhe integrimin e përdorimit të qëndrueshëm të tokës, projektimit, ndërtimit dhe shkatërrimit. Udhëzimet, rregulloret dhe/ose politikat janë të dizajnuara për të mbrojtur burimet natyrore dhe kulturore, janë krijuar me kontribute lokale nga publiku dhe një proces i plotë shqyrtimi, janë komunikuar publikisht dhe zbatohen</p>	<p>IN-A7.a. Udhëzimet, rregulloret dhe/ose politikat e planifikimit ose zonimit që mbrojnë burimet natyrore dhe kulturore</p> <p>IN-A7.b. Udhëzimet, rregulloret dhe/ose politikat që trajtojnë përdorimin e qëndrueshëm të tokës, projektimin, ndërtimin dhe shkatërrimin</p> <p>IN-A7.c. Udhëzimet, rregulloret dhe/ose politikat e planifikimit u krijuan me kontribute lokale nga publiku dhe proces të mirëfilltë shqyrtimi</p> <p>IN-A7.d. Udhëzimet, rregulloret dhe/ose politikat e planifikimit publikisht komunikohen dhe zbatohen</p>
<p>A8 Qasje për të gjithë</p> <p>Sipas nevojës, lokacionet dhe ndërtesat, duke përfshirë ato me rëndësi natyrore dhe kulturore, janë të qasshme për të gjithë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe të tjerët që kanë kërkesa specifike për qasje. Aty ku lokacionet dhe ndërtesat e tilla nuk janë menjëherë të qasshme, qasja sigurohet përmes hartimit dhe zbatimit të zgjidhjeve që marrin parasysh si integritetin e lokacionit, ashtu edhe strehim të arsyeshëm për personat me nevoja për qasje që mund të arrihen.</p>	<p>IN-A8.a. Politikat që mbështesin qasjen në destinacionet dhe objektet turistike, duke përfshirë ato me rëndësi natyrore dhe kulturore, për individët me aftësi të kufizuara dhe të tjerë që kanë kërkesa specifike për qasje, aty ku është e përshtatshme</p> <p>IN-A8.b. Zgjidhjet e qasshmërisë janë të dizajnuara për të marrë parasysh integritetin e destinacionit duke bërë akomodimin e arsyeshëm për njerëzit me aftësi të kufizuara</p>

A9 Blerjet e pronave

Ekzistojnë ligje dhe rregullore lidhur me blerjen e pronave, ato zbatohen, janë në pajtim me të drejtat komunale dhe vendase, sigurojnë konsultime publike dhe nuk autorizojnë rivendosjen pa pëlqimin paraprak të informuar dhe/ose kompensim të arsyeshëm.

IN-A9.a. Ekzistojnë politika ose legjislacion, duke përfshirë dispozitat e zbatimit

IN-A9.b. Politika ose legjislacioni që i konsideron të drejtat autoktone, siguron konsultimin publik dhe autorizon rivendosjen vetëm kur ka pëlqim të informuar dhe/ose kompensim të arsyeshëm

A10 Kënaqësia e vizitorëve

Destinacioni ka sistem për të monitoruar dhe raportuar publikisht kënaqësinë e vizitorëve dhe, nëse është e nevojshme, të ndërmarrë veprime për të përmirësuar kënaqësinë e vizitorëve

IN-A10.a. Mbledhja dhe raportimi publik i të dhënave për kënaqësinë e vizitorëve

IN-A10.b. Sistem për të ndërmarrë veprime për të përmirësuar kënaqësinë e vizitorëve në bazë të informacioneve të monitorimit

A11 Standardet e qëndrueshmërisë

Destinacioni ka një sistem për të promovuar standardet e qëndrueshmërisë për ndërmarrjet në përputhje me Kriteret GSTC. Destinacioni bën publike një listë të ndërmarrjeve të certifikuara ose të verifikuara të qëndrueshmërisë.

IN-A11.a. Certifikimi i qëndrueshëm i turizmit i mbështetur nga industria ose sistemi i menaxhimit të mjedisit jetësor

IN-A11.b. Certifikimi i qëndrueshëm i turizmit ose sistemi i menaxhimit të mjedisit jetësor i njohur nga GSTC

IN-A11.c. Monitorimi i pjesëmarrjes së bizneseve turistike në certifikimin e turizmit ose sistemin e menaxhimit të mjedisit jetësor

IN-A11.d. Lista në dispozicion publik e ndërmarrjeve të certifikuara ose verifikuara për qëndrueshmëri

A12 Mbrojtje dhe siguri

Destinacioni ka një sistem për të monitoruar, parandaluar, raportuar publikisht dhe për t'iu përgjigjur ndaj krimit, sigurisë dhe problemeve të shëndetit.

IN-A12.a. Inspektimet e detyrueshme në vazhdim të zjarrit, higjienë së ushqimit dhe sigurisë së energjisë elektrike për pronat e turizmit

IN-A12.b. Masa paraprake të sigurisë siç janë stacionet e ndihmës së parë në plazhet/vendet turistike

IN-A12.c. Sistemi për parandalimin e dhe reagimit ndaj krimit

IN-A12.d. Sistemi i licencimit të taksive me çmime të qarta dhe një sistem i organizuar për dërgimin e taksive në pikat e hyrjes së vizitorëve

IN-A12.e. Raportimi publik i mbrojtjes dhe sigurisë

A13 Menaxhimi i krizave dhe urgjencave

Destinacioni ka një plan reagimi në rast të krizës ose urgjencës që është i përshtatshëm për destinacionin. Elementët kyç u komunikohen banorëve, vizitorëve dhe ndërmarrjeve. Plani përcakton procedurat dhe siguron burime dhe trajnime për stafin, vizitorët dhe banorët, dhe përditësohet rregullisht.

IN-A13.a. Plan reagimi në rast të krizës ose urgjencës në dispozicion të publikut që merr parasysh sektorin e turizmit

IN-A13.b. Kapitali financiar dhe njerëzor për zbatimin e planit të reagimit në rast të krizës ose urgjencës

IN-A13.c. Plan reagimi në rast të krizës ose urgjencës zhvilluar me kontributin e sektorit privat të turizmit dhe përfshin procedurat e komunikimit për gjatë dhe pas krizës ose emergjencës

IN-A13.d. Plani i reagimit në rast të krizës ose urgjencës siguron burime dhe trajnime për stafin, vizitorët dhe banorët

IN-A13.e. Plani i reagimit në rast të krizës dhe emergjencës përditësohet rregullisht

A14 Promovim

Promovimi është i saktë në lidhje me destinacionin dhe produktet, shërbimet dhe pretendimet e saj të qëndrueshmërisë. Mesazhet promovuese trajtojnë komunitetet lokale dhe turistët në mënyrë autentike dhe me respekt

IN-A14.a. Mesazhet promovuese të vendit që përfaqësojnë komunitetet lokal dhe vizitorët në mënyrë autentike dhe me respekt

IN-A14.b. Mesazhet promovuese të vendit që janë të sakta në përshkrimin e tyre të produkteve dhe shërbimeve

SEKSIONI B: Maksimizoni përfitimet ekonomike për komunitetin mikpritës dhe minimizoni ndikimet negative

B1 Monitorim ekonomik

Kontributi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i turizmit në ekonominë e vendit monitorohet dhe raportohet publikisht të paktën një herë në vit. Për aq sa është e mundur, kjo duhet të përfshijë shpenzimet e vizitorëve, të ardhurat nga dhomat në dispozicion, të dhënat e punësimeve dhe investimeve.

IN-B1.a. Monitorimi i rregullt dhe raportimi i të dhënave të shpenzimeve të vizitorëve, të ardhurat për dhomën në dispozicion, të dhënat e punësimeve dhe investimeve
IN-B1.b. Monitorimi i rregullt dhe raportimi të paktën një herë në vit i kontributeve direkte dhe indirekte të turizmit
IN-B1.c. Mbledhja dhe raportimi publik të paktën një herë në vit të të dhënave të punësimit të turizmit, të ndara sipas gjinisë dhe grupmoshave

B2 Mundësitë lokale të karrierës

Ndërmarrjet e destinacionit ofrojnë punësim të barabartë, mundësi për trajnim, siguri në punë dhe paga të drejta për të gjithë.

IN-B2.a. Legjislacioni ose politika që mbështesin mundësitë e barabarta në punësim për të gjithë, duke përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe popullatë tjetër të rrezikuar
IN-B2.b. Programe trajnimi që sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë, duke përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe popullatë tjetër të rrezikuar
IN-B2.c. Legjislacioni ose politikat që mbështesin siguri në punë për të gjithë
IN-B2.d. Legjislacioni ose politikat që mbështesin pagat e drejta për të gjithë, duke përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe popullatë tjetër të rrezikuar

B3 Pjesëmarrja e publikut

Destinacioni ka sistem që inkurajon pjesëmarrjen e publikut në planifikimin dhe vendimmarrje në vend në mënyrë të vazhdueshme.

IN-B3.a. Sistemi për përfshirjen e palëve publike, private dhe të komunitetit në planifikimin e menaxhimit të vendit dhe vendimmarrjen
IN-B3.b. Takime publike për të diskutuar çështjet e menaxhimit të vendit çdo vit

B4 Mendimi i komunitetit lokal

Aspiratat, shqetësimet dhe kënaqshmëria e komuniteteve lokale me menaxhimin e destinacionit monitorohen rregullisht, regjistrohen dhe raportohen publikisht në kohën e duhur.

IN-B4.a. Mbledhja, monitorimi, regjistrimi dhe raportimi i rregullt i të dhënave për aspiratat, shqetësimet dhe kënaqshmërinë e rezidentëve me menaxhimin e vendit
IN-B4.b. Mbledhja, monitorimi, regjistrimi dhe regjistrimi publik i të dhënave ndodh në kohë të duhur

B5 Qasje lokale

Destinacioni monitoron, mbron dhe, kur është e nevojshme, rehabiliton ose rikthen qasjen e komunitetit lokal në vendet natyrore dhe kulturore.

IN-B5.a. Programet për monitorimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin ose rivendosjen e qasjes publike nga vendasit dhe vizitorët vendas në vendet natyrore dhe kulturore
IN-B5.b. Monitorimi i sjelljes dhe karakteristikat e vizitorëve lokal, vendas dhe të huaj në vendet turistike dhe atraksionet

B6 Ndërgjegjësimi dhe edukimi turistik

Destinacioni ofron programe të rregullta për komunitetet e prekura për të rritur kuptimin e tyre për mundësitë dhe sfidat e turizmit dhe rëndësinë e qëndrueshmërisë

IN-B6.a. Program për të rritur ndërgjegjësimin për rolin e turizmit dhe kontributin e mundshëm që përmbahet në komunitetet, shkollat dhe institucionet e arsimit të lartë

B7 Parandalimi i shfrytëzimit

Vendi ka ligje dhe praktika të vendosura për të parandaluar shkaqet komerciale, seksuale apo ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit dhe ngacmimit të kujtdo, sidomos të fëmijëve, adoleshentëve, grave dhe pakicave. Ligjet dhe praktikatat e vendosura komunikohen publikisht.

IN-B7.a. Ligje dhe program për të parandaluar formën komerciale, seksuale apo ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit, diskriminimit ose ngacmimit të banorëve ose vizitorëve

IN-B7.b. Ligjet dhe programet komunikohen publikisht

B8 Mbështetje për komunitetin

Destinacioni ka sistem për të mundësuar dhe inkurajuar ndërmarrjet, vizitorët dhe publikun që të kontribuojë në iniciativat e komunitetit dhe qëndrueshmërisë

IN-B8.a. Programe për ndërmarrjet, vizitorët dhe publikun për të kontribuar me donacione për iniciativat e konservimit të komunitetit dhe biodiversitetit dhe/ose zhvillimin e infrastrukturës

B9 Mbështetja e sipërmarrësve vendorë dhe tregtisë së ndershme

Destinacioni ka sistem që mbështet ndërmarrjet lokale e të vogla dhe të mesme dhe promovon dhe zhvillon produkte të qëndrueshme lokale dhe parime të tregtisë së drejtë që bazohen në natyrën dhe kulturën e zonës. Këto mund të përfshijnë ushqim dhe pije, zanate, artet e performancës, produktet bujqësore etj.

IN-B9.a. Program për mbështetjen dhe ndërtimin e kapaciteteve të ndërmarrjeve lokale e të vogla dhe të mesme

IN-B9.b. Programi inkurajon ndërmarrjet për të blerë mallra dhe shërbime lokale

IN-B9.c. Program për të promovuar dhe zhvilluar produkte të qëndrueshme lokale bazuar në natyrën dhe kulturën lokale

IN-B9.d. Program për të përfshirë artizanët, fermerët dhe furnizuesit vendas në zinxhirin e vlerave turistike

SEKSIONI C: Maksimizo përfitimet për komunitetet, vizitorët dhe kulturën; minimizo ndikimet negative

C1 Mbrojtje e atraksioneve

Destinacioni ka politikë dhe sistem për vlerësim, rehabilitim dhe ruajtje të vendeve natyrore dhe kulturore, duke përfshirë trashëgiminë e ndërtuar (historike dhe arkeologjike) dhe pikëpamjet skenike rurale dhe urbane

IN-C1.a. Sistemi i menaxhimit për të mbrojtur vendet natyrore dhe kulturore, duke përfshirë trashëgiminë e ndërtuar dhe pikëpamjet skenike rurale dhe urbane

IN-C1.b. Sistemi i menaxhimit për të monitoruar, matur dhe zbutur ndikimet e turizmit në vendet dhe atraksionet

C2 Menaxhimi i vizitorëve

Destinacioni ka sistem të menaxhimit të vizitorëve për vendet tërheqëse që përfshijnë masa për ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e pasurive natyrore dhe kulturore.

IN-C2.a. Mekanizmi administrativ përgjegjës për zbatimin e planeve dhe operacioneve të menaxhimit të vizitorëve

C3 Sjellja e vizitorëve

Destinacioni ka publikuar dhe ka dhënë udhëzime për sjelljen e duhur të vizitorëve në vendet e ndjeshme. Udhëzime të tilla janë të dizajnuara për të minimizuar ndikimet negative në vendet e ndjeshme dhe për të forcuar sjelljet pozitive të vizitorëve.

IN-C3.a. Udhëzimet kulturore dhe të mjedisit jetësor për sjelljen e vizitorëve në faqet e ndjeshme

IN-C3.b. Kodi i praktikës për udhëzuesit turistik dhe operatorët turistikë

C4 Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

Destinacioni ka ligje që rregullojnë shitjen, tregtimin, shfaqjen e duhur, ose dhurimin e artefakteve historike dhe arkeologjike.

IN-C4.a. Ligje ose rregullore për të mbrojtur objektet historike dhe arkeologjike, duke përfshirë ato që ndodhen nën ujë dhe prova për zbatimin e tyre

IN-C4.b. Program për të mbrojtur dhe festuar trashëgiminë kulturore të paprekshme (p.sh. përfshin këngë, muzikë, dramë, shkathtësi dhe vepra artizanale)

C5 Interpretimi i vendit

Informata të sakta interpretuese ofrohen në vendet natyrore dhe kulturore. Informacioni është i përshtatshëm në aspektin kulturor, i zhvilluar në bashkëpunim me komunitetin dhe komunikuar në gjuhët përkatëse për vizitorët.

IN-C5.a. Informacion interpretues në dispozicion të vizitorëve në zyrat turistike dhe në vendet natyrore dhe kulturore

IN-C5.b. Informacioni interpretues është i përshtatshëm në aspektin kulturor

IN-C5.c. Informacioni interpretues zhvillohet me bashkëpunim me komunitetin

IN-C5.d. Informacioni interpretues është në dispozicion në gjuhët përkatëse për vizitorët

IN-C5.e. Trajnimi i udhëzuesve turistik në përdorimin e informacionit interpretues

C6 Prona intelektuale

Vendi ka sistem për të kontribuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale të komuniteteve dhe individëve.

IN-C6.a. Ligje, rregullore ose programe për të mbrojtur të drejtat e pronësisë intelektuale të individëve dhe komuniteteve vendore

SEKSIONI D: Maksimizoni përfitimet për mjedisin jetësor dhe minimizoni ndikimet negative

D1 Rreziqet e mjedisit jetësor

Destinacioni ka identifikuar rreziqet e mjedisit jetësor dhe ka sistem në vend për t'i adresuar ato.

IN-D1.a. Vlerësim i qëndrueshmërisë së destinacionit brenda pesë viteve të fundit, duke identifikuar rreziqet e mjedisit jetësor

IN-D1.b. Sistem i vendosorpër të adresuar rreziqet e identifikuar

D2 Mbrojtja e mjediseve jetësore të ndjeshme

Destinacioni ka sistem për të monitoruar ndikimin mjedisor të turizmit, ruajtjen e habitateve, specieve dhe ekosistemeve dhe parandalimin e futjes së specieve invazive.

IN-D2.a. Inventar i mirëmbajtur dhe i përditësuar i gjallesave të egra dhe habitateve të ndjeshme dhe të kërcënuara

IN-D2.b. Sistemi i menaxhimit për të monitoruar ndikimet dhe për të mbrojtur ekosistemet, mjediset e ndjeshme dhe speciet

IN-D2.c. Sistemi parandalon futjen e specieve invazive

D3 Mbrojtja e gjallesave të egra

Destinacioni ka sistem për të siguruar përputhjen me ligjet dhe standardet lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për grumbullimin ose kapjen, shfaqjen dhe shitjen e gjallesave të egra (përfshirë bimët dhe kafshët).

IN-D3.a. Konventa mbi tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të faunës dhe florës së egër (CITES)

IN-D3.b. Rregulloret dhe standardet për kontrollin e grumbullimit ose kapjes, shfaqjes, shitjes të bimëve dhe kafshëve

D4 Emetimet e gazrave serë

Destinacioni i ka sistem për të inkurajuar ndërmarrjet për të matur, monitoruar, minimizuar, raportuar publikisht dhe për të zbutur emetimet e gazrave të tyre nga të gjitha aspektet e operimit të tyre (duke përfshirë emetimet nga ofruesit e shërbimeve).

IN-D4.a. Program për të ndihmuar ndërmarrjet për të matur, monitoruar, minimizuar dhe raportuar publikisht emetimet e gazrave serrë

IN-D4.b. Sistem për të ndihmuar ndërmarrjet për të zbutur emetimet e gazrave serrë

D5 Ruajtja e energjisë

Destinacioni ka një sistem për të inkurajuar ndërmarrjet për të matur, monitoruar, zvogëluar dhe raportuar publikisht konsumin e energjisë dhe për të zvogëluar varësinë nga lëndët djegëse fosile.

IN-D5.a. Program për promovimin e ruajtjes së energjisë dhe matjen, monitorimin, zvogëlimin dhe raportimin publik të konsumimit të energjisë

IN-D5.b. Politika dhe nxitje për të reduktuar varësinë nga lëndët djegëse fosile, për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe për të inkurajuar miratimin dhe përdorimin e teknologjive të energjisë së rinovueshme

D6 Menaxhimi i Ujit

Destinacioni ka një sistem për të inkurajuar ndërmarrjet për të matur, monitoruar, zvogëluar dhe raportuar publikisht përdorimin e ujit.

IN-D6.a. Program për të ndihmuar ndërmarrjet për të matur, monitoruar, zvogëluar dhe raportuar publikisht përdorimin e ujit

D7 Siguria e ujit

Destinacioni ka sistem për të monitoruar burimet ujore për të siguruar që përdorimi nga ndërmarrjet është në përputhje me kërkesat e ujit të komunitetit të vendit.

IN-D7.a. Sistem i menaxhimit për të siguruar që përdorimi i ujit nga ndërmarrjet dhe kërkesat e ujit të komunitetit të vendit janë të balancuara dhe të pajtueshme

D7 Siguria e ujit

Destinacioni ka sistem për të monitoruar burimet ujore për të siguruar që përdorimi nga ndërmarrjet është në përputhje me kërkesat e ujit të komunitetit të vendit.

IN-D7.a. Sistem i menaxhimit për të siguruar që përdorimi i ujit nga ndërmarrjet dhe kërkesat e ujit të komunitetit të vendit janë të balancuara dhe të pajtueshme

D8 Cilësia e ujit

Destinacioni ka sistem për të monitoruar cilësinë e ujit të pijshëm dhe rekreativ duke përdorur standardet e cilësisë. Rezultatet e monitorimit janë në dispozicion të publikut dhe destinacioni ka sistem për të reaguar në kohën e duhur për çështjet e cilësisë së ujit

IN-D8.a. Sistem i menaxhimit për të monitoruar dhe raportuar publikisht mbi cilësinë e ujit të pijshëm dhe rekreativ

IN-D8.b. Rezultatet e monitorimit janë në dispozicion të publikut

IN-D8.c. Sistem për t'iu përgjigjur në kohën e duhur për çështjet e cilësisë së ujit

D9 Ujërat e zeza

Destinacioni ka udhëzime të qarta dhe të zbatuara për vendosjen, mirëmbajtjen dhe testimin e shkarkimeve nga gropat septikave dhe sistemet e trajtimit të ujërave të zeza dhe siguron që mbetjet të trajtohen siç duhet dhe të ripërdoren ose të lëshohen në mënyrë të sigurt me efekte negative minimale ndaj popullatës lokale dhe mjedisit jetësor.

IN-D9.a. Rregulloret për vendosjen, mirëmbajtjen dhe testimin e shkarkimeve nga gropat septike dhe sistemet e trajtimit të ujërave të zeza, si dhe dëshmi për zbatimin e tyre

IN-D9.b. Rregulloret për të siguruar që madhësia dhe lloji i trajtimit të ujërave të zeza janë adekuate për lokacionin dhe dëshmi për zbatimin e tyre

IN-D9.c. Program për të ndihmuar ndërmarrjet në mënyrë efektive për të trajtuar dhe ripërdorur ujërat e zeza

IN-D9.d. Programi për të siguruar trajtimin e duhur të mbeturinave dhe ripërdorimin ose lëshimin e sigurt me efekte minimale negative për popullatën lokale dhe mjedisin jetësor